



Bazuar në nenin 35 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), në pajtim me nenin 4 paragrafi 3, nenin 118 paragrafi 1, nenin 119 paragrafi 2 dhe nenin 120 paragrafi 9 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 38 / 24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2017, miratoi:

Rregullore për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktoj kriteret, procedurat dhe afatet për licencimin e ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe risigurimeve.
2. Kjo rregullore do të zbatohet për të gjithë personat fizik dhe juridik, që kërkojnë licencë nga BQK-ja për t'u angazhuar në veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime.

Neni 2

Përkufizime

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuara në nenin 3 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet (në vijim: Ligji për Sigurimet) ose/dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Ndërmjetësim në sigurime** - nënkupton veprimtarinë e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore, deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënies së asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi.
 - 1.2. **Ndërmjetësues në sigurime** - nënkupton personin fizik apo juridik i licencuar nga BQK-ja dhe i kontraktuar nga siguruesi për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime;
 - 1.3. **Degë e kompanisë së jashtme ndërmjetësuese** - nënkupton degën ligjërisht të varur të kompanisë së agjentëve ose kompanisë së brokerëve, e cila kompani ka selinë kryesore në ndonjë vend jashtëm, dhe është licencuar për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime në Republikën e Kosovës;

- 1.4. **Kompani ndërmjetësuese** - nënkupton kompaninë e agjentëve dhe kompaninë e brokerimit;
- 1.5. **Agjenti i sigurimeve** - nënkupton personin fizik, i licencuar nga BQK-ja dhe i kontraktuar nga siguruesi sipas një kontrate ndërmjetësimi për të zhvilluar veprimtari ndërmjetësimi në sigurime në llogari të siguruesve. Përveç kësaj, agjent i sigurimeve konsiderohet edhe personi fizik që është në marrëdhënie të rregullt pune me kompaninë e agjentëve, bankën ose agjensionin e udhëtimit të licencuar për veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime, për të vepruar në llogari të siguruesve.
- 1.6. **Kompani e agjentëve** - nënkupton personin juridik e licencuar nga BQK-ja dhe e kontraktuar nga një ose me shumë sigurues, që të zhvillojë veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime, në llogari të siguruesit.
- 1.7. **Brokleri i sigurimeve** - nënkupton personin fizik, i licencuar nga BQK-ja që të zhvilloj aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime dhe që vepron në llogari të të siguruarve. Brokleri ndërmjetëson në mes të të siguruarve dhe një ose më shumë siguruesve me të cilët ka marrëdhënie kontraktuale. Përveç kësaj, broker i sigurimeve konsiderohen edhe personi fizik që është në marrëdhënie të rregullt pune me kompaninë e brokerimit ose bankën e licencuar për veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime.
- 1.8. **Kompani e brokerimit** - nënkupton personin juridik i licencuar nga BQK-ja që të zhvilloj veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime në llogari të të siguruarve. Kompania e brokerimit ndërmjetëson në mes të të siguruarve dhe një ose më shumë siguruesve me të cilët ka marrëdhënie kontraktuale.
- 1.9. **Menaxher i lartë**- nënkupton kryeshefin ekzekutiv, zëvendëskryeshefin ekzekutiv dhe zyrtarin kryesor financiar të kompanisë ndërmjetësuese në sigurimeve.
- 1.10. **Drejtor** - nënkupton anëtarin e bordit të drejtorëve të kompanisë ndërmjetësuese në sigurime.

Neni 3

Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime

1. Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime do të ushtrohet në pajtim me Kapitullin XIX të Ligjit për Sigurimet.
2. Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime do të ushtrohet nga agjentët e sigurimeve, kompanitë e agjentëve, brokerët e sigurimeve dhe kompanitë e brokerimit.
3. Përveç siç është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime mund të ushtrohet edhe nga bankat që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Kosovës, pasi ato të licencohen nga BQK-ja për veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime sipas kërkesave të kësaj rregullore dhe agjencionet e udhëtimit vetëm sa i përket produktit të sigurimit të shëndetit në udhëtim. Agjensioni i udhëtimit nuk mund të licencohet për veprimtari të brokerëve.

4. Kompanitë e agjentëve, mund të licencohen për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit të sigurimit jetë dhe jo jetë në të njëjtën kohë, me kusht që këto veprimtari të ushtrohen ndaras nga agjentë të licencuar për të ndërmjetësuar sigurimin e jetës respektivisht jo-jetës.
5. Bankat e licencuara si ndërmjetësues në sigurime, mund të licencohen për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime jetë dhe jo-jetë në të njëjtën kohë, me kusht që këto veprimtari të ushtrohen ndaras nga punonjësit e bankës, të cilët janë të licencuar si agjent të sigurimeve për të ndërmjetësuar sigurimin e jetës respektivisht jo- jetës.
6. Bankat e licencuara për veprimtarinë e agjentëve në sigurime mund të ndërmjetësojnë për më shumë se një sigures në të njëjtën kohë, me kusht që klasat e sigurimeve që ndërmjetësojnë nuk janë të njëjta. Në raste të tilla, banka duhet të siguroj miratimin e BQK-së.
7. Agjentët në sigurime të licencuar si persona fizik, nuk lejohet që në të njëjtën kohë të ndërmjetësojnë për sigures të ndryshëm.
8. Kompanitë e agjentëve mund të ndërmjetësojnë për më shumë se një sigures në të njëjtën kohë, me kusht që klasat e sigurimeve që ndërmjetësojnë nuk janë të njëjta. Në raste të tilla, kompania e agjentëve duhet të siguroj miratimin e BQK-së.
9. Brokerët dhe kompanitë e brokerimit mund të licencohen për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit të sigurimit jetë dhe jo- jetë në të njëjtën kohë.

Neni 4

Kriteret për licencimin e agjentëve si ndërmjetësues në sigurime

1. Personi fizik, i cili kërkon të licencohet si agjent në sigurime duhet t'i plotësojë kriteret si në vijim:
 - 1.1. të ketë të përfunduar së paku shkollimin e mesëm;
 - 1.2. të ketë dhënë provimin profesional për agjent;
 - 1.3. të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregulloreje;
 - 1.4. të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg;
 - 1.5. të mos jetë punëtor i ndonjë kompanie sigurimi;
 - 1.6. të ketë një para-kontratë me një kompani të sigurimeve për të vepruar si agjent i saj;
 - 1.7. të jetë rezident i Republikës së Kosovës;
 - 1.8. të ketë njohuri të njërës nga gjuhët zyrtare të Kosovës;
 - 1.9. të jetë i regjistruar në regjistrin e bizneseve në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare si biznes individual;
 - 1.10. të ketë objekt të përshtatshëm për të ushtruar veprimtarinë e ndërmjetësimit;
 - 1.11. të ketë të paguar tarifën për licencim sipas kësaj rregullore.
2. Polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale, nuk është e obligueshme të dorëzohet në BQK në momentin e dorëzimit të aplikacionit;

3. Në rastet e kërkesave për licencim të agjentëve, që do të kryejnë veprimtarinë si të punësuar të kompanive të agjentëve, kriteret e përcaktuara me nënparagrafet 1.3. 1.6. dhe 1.9. të paragrafit 1. të këtij neni, nuk aplikohen.
4. Kërkesa për licencim sipas këtij neni, duhet të shoqërohet me dokumentacion përkatës që dëshmon përmbushjen e kriterëve të përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni.
5. Kërkesa për licencim dhe dokumentacioni përkatës sipas këtij neni, duhet të bëhet nga personi që aplikon për licencim. Në rastin e licencimit të agjentëve si të punësuar të kompanive të agjenteve, bankave ose agjensionit të udhëtimit, kërkesa për licencim duhet të bëhet nga kompania e agjentëve respektivisht banka ose agjensioni i udhëtimit.
6. Gjatë shqyrtimit të aplikacionit për licencim sipas këtij neni, BQK-ja nëse e vlerëson të nevojshme mund të kërkojë dokumentacion tjetër plotësues.

Neni 5

Kriteret për licencimin e kompanisë së agjentëve si ndërmjetësues në sigurime

1. Personi juridik që paraqet kërkesë për licencim si kompani e agjentëve, duhet t'i plotësojë kriteret si në vijim:
 - 1.1. të jetë i regjistruar në regjistrin e bizneseve, si shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin për shoqëritë tregtare;
 - 1.2. aksionarët e tij, të jetë në gjendje të mirë financiare dhe të mos kenë obligime tatimore të papaguara me kohë;
 - 1.3. të ketë të punësuar me kohë të plotë, së paku një agjent të licencuar;
 - 1.4. të paguajë dhe mirëmbajë në çdo kohë kapitalin në vlerë prej së paku 5,000 euro. Ky kapital duhet të paguhet në një nga bankat e licencuara nga BQK-ja dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera;
 - 1.5. plani i parashikuar i biznesit për së paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë, i cili duhet të jetë i bazuar në analiza dhe supozime të arsyeshme;
 - 1.6. aksionarët, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe kryeshefi ekzekutiv, të propozuar, të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg si dhe të mos kenë qenë drejtor ose kryeshef ekzekutiv të ndonjë siguruesi gjatë gjashtë (6) muajve të fundit nga momenti i aplikimit;
 - 1.7. aksionarët e kompanisë së agjentëve nuk duhet të jenë njëkohësisht edhe aksionarë të siguruesit, pavarësisht përqindjes që e kanë në kompaninë e agjentëve dhe /apo siguruesit.
 - 1.8. të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregullore;
 - 1.9. të ketë objekte të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj sipas kërkesave të përcaktuara me këtë rregullore;
2. Kërkesës për licencim si kompani e agjentëve duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni në vijim:
 - 2.1. formulari i BQK-së për aplikim, i plotësuar;

- 2.2.certifikata e regjistrimit të biznesit;
 - 2.3.akti e themelimit dhe statuti;
 - 2.4.struktura e kapitalit themeltar dhe prejardhja e tij;
 - 2.5.struktura organizative;
 - 2.6.para-kontrata e lidhur me siguruesin në emër dhe në llogari të së cilit do të zhvilloj veprimtarinë;
 - 2.7.biografite e plota të aksionarëve, drejtorëve (nëse është e aplikueshme) dhe kryeshefit ekzekutiv të propozuar, si dhe pasqyrat financiare të aksionarëve për tri vitet e fundit nëse janë të aplikueshme;
 - 2.8.plani i parashikuar i biznesit;
 - 2.9.dokumentet që vërtetojnë se kompania disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë e saj;
 - 2.10. dëshmi për sigurim nga përgjegjësia profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregullore;
 - 2.11. kopje të licencave të agjentëve;
 - 2.12. dëshmi për pagesën e kapitalit themeltar;
 - 2.13. dëshmi për pagesën e tarifës për licencim sipas kësaj rregullore;
 - 2.14. dokumentacion tjetër që vërteton përmbushjen e kërkesave të paragrafit 1 të këtij neni;
3. Në rastin kur personi juridik që kërkon të licencohet si kompani e agjentëve, është subjekt i varur i ndonjë kompanie të jashtme të agjentëve, e cila është e licencuar si kompani e agjentëve në vendin e origjinës, përveç dokumentacionit sipas paragrafit 2 të këtij neni, duhet të paraqes në BQK edhe pëlqimin me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës si dhe miratimin zyrtar nga organet përgjegjëse të kompanisë së jashtme të agjentëve.
 4. Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, nuk është e obligueshme të dorëzohet në BQK në momentin e dorëzimit të aplikacionit
 5. Gjatë shqyrtimit të aplikacionit për licencim sipas këtij neni, BQK-ja nëse e vlerëson të nevojshme mund të kërkojë dokumentacion tjetër plotësues.

Neni 6

Kriteret për licencimin e brokerëve si ndërmjetësues në sigurime

1. Personi fizik i cili kërkon të licencohet si broker në sigurime, duhet t'i plotësojë kriteret si në vijim:
 - 1.1.të ketë të përfunduar studimet universitare;
 - 1.2.të ketë dhënë provimin profesional për broker;
 - 1.3.të ketë përvojë pune së paku njëvjeçare në fushën e sigurimeve apo të ketë përvojë pune së paku dy vjeçare në fushën e shërbimeve financiare;
 - 1.4.të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg;
 - 1.5.të mos jetë i punësuar në ndonjë sigurues;
 - 1.6.të mos ketë qenë kryeshef ekzekutiv apo anëtar i bordit të ndonjë siguresi, gjatë 6 muajve të fundit nga momenti i aplikimit;

- 1.7.të jetë i regjistruar në regjistrin e bizneseve si biznes individual në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
 - 1.8.të mos ketë obligime tatimore të papaguara;
 - 1.9.të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregulloreje;
 - 1.10. të ketë paguar tarifën për licencim sipas kësaj rregullore;
 - 1.11. të ketë objekt të përshtatshëm për të ushtruar veprimtarinë e ndërmjetësimit sipas përcaktimeve të kësaj rregullore.
2. Kërkesa për licencim sipas këtij neni, duhet të paraqitet me shkrim nga personi, i cili kërkon të licencohet, dhe e njëjta duhet të shoqërohet me dokumentacion përkatës, që dëshmon përmbushjen e kriterëve të përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni. Në rastin e licencimit të brokerave si të punësuar të kompanive të brokerimit apo bankave, kërkesa për licencim duhet të bëhet nga kompania e brokerimit respektivisht banka.
 3. Në rastet e kërkesave për licencim të brokerëve, që do të kryejnë veprimtarinë si të punësuar të kompanive të brokerimit, kriteret e përcaktuara me nënparagrafet 1.7. dhe 1.9. të paragrafit 1. të këtij neni, nuk aplikohen.
 4. Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, nuk është e obligueshme të dorëzohet në BQK në momentin e dorëzimit të aplikacionit.
 5. Gjatë shqyrtimit të aplikacionit për licencim sipas këtij neni, BQK-ja nëse e vlerëson të nevojshme mund të kërkojë dokumentacion tjetër plotësues.

Neni 7

Kriteret për licencimin e kompanive të brokerimit si ndërmjetësues në sigurime

1. Personi juridik që paraqet kërkesë për licencim si kompani e brokerimit, duhet t'i plotësojë kriteret si në vijim:
 - 1.1.të jetë i regjistruar si shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
 - 1.2.aksionarët e tij, të jenë në gjendje të mirë financiare dhe të mos kenë obligime tatimore të papaguara me kohë;
 - 1.3.aksionarët, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherët e lartë të propozuar të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për veprë penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg si dhe të mos kenë qenë drejtor ose kryeshef ekzekutiv të ndonjë siguruesi gjatë gjashtë (6) muajve të fundit nga momenti i aplikimit;
 - 1.4.aksionarët e kompanisë së brokerëve nuk duhet të jenë njëkohësisht edhe aksionar të siguruesit, pavarësisht përqindjes që e kanë në kompaninë e brokerëve dhe /apo siguruesit.
 - 1.5.plani i biznesit për se paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë, i cili duhet të jetë i bazuar në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;
 - 1.6.të ketë të punësuar me kohë të plotë, së paku një (1) broker të licencuar;

- 1.7. të paguajë dhe mirëmbajë në çdo kohë kapitalin themeltar në vlerë prej së paku dhjetë mijë (10,000) euro. Ky kapital duhet të paguhet në një nga bankat e licencuara nga BQK-ja dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera;
 - 1.8. të këtë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregullore;
 - 1.9. të ketë objekte të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj sipas përcaktimeve të kësaj rregullore.
2. Kërkesës për licencim si kompani e brokerimit duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni në vijim:
 - 2.1 formulari i BQK-se për aplikim, i plotësuar;
 - 2.2 certifikata e regjistrimit të biznesit;
 - 2.3 biografite e plota të aksionarëve, drejtorëve (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherëve të saj si dhe pasqyrat financiare nëse janë të aplikueshme;
 - 2.4 akti i themelimit dhe statuti;
 - 2.5 struktura e kapitalit themeltar dhe prejardhja e tij;
 - 2.6 struktura organizative;
 - 2.7 plani i biznesit;
 - 2.8 dokumenti që vërteton se kompania disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë si broker në sigurime, përfshirë edhe instalimin e sistemit të informatizuar të raportimit të të dhënave në BQK;
 - 2.9 dëshmi të sigurimit nga përgjegjësia profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregulloreje;
 - 2.10 kopje të licencave të brokerëve;
 - 2.11 dëshmi të pagesës së kapitalit themeltar;
 - 2.12 dëshmi për pagesën e tarifës për licencim sipas kësaj rregullore;
 - 2.13 dokumentacion tjetër që vërteton përmbushjen e kërkesave të paragrafit 1 të këtij neni.
 3. Në rastin kur personi juridik që kërkon të licencohet si kompani e brokerimit, është subjekt i varur i ndonjë kompanie të jashtme të brokerimit e cila është e licencuar si kompani e brokerimit në vendin e origjinës, përveç dokumentacionit sipas paragrafit 2 të këtij neni, duhet të paraqes në BQK edhe pëlqimin me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës si dhe miratimin zyrtar nga organet përgjegjëse të kompanisë së jashtme të brokerimit, për hapjen e subjektit të varur në Kosovë.
 4. Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, nuk është e obligueshme të dorëzohet në BQK në momentin e dorëzimit të aplikacionit
 5. Gjatë shqyrtimit të aplikacionit për licencim sipas këtij neni, BQK-ja nëse e vlerëson të nevojshme mund të kërkojë dokumentacion tjetër plotësues.

Neni 8

Licencimi i degëve të kompanive të jashtme si ndërmjetësues në sigurim

1. Asnjë kompani e jashtme ndërmjetësuese, nuk mund të ushtrojë veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime në Republikën e Kosovës, pa marrë licencë nga BQK-ja sipas kësaj Rregullore.
2. Kompania e jashtme ndërmjetësuese që paraqet kërkesë për licencim të degës së saj në Republikën e Kosovës, duhet t'i plotësojë kriteret si në vijim:
 - 2.1. të jetë e licencuar si kompani ndërmjetësuese në sigurime, në vendin e origjinës;
 - 2.2. ta ketë pëlqimin me shkrim për hapjen e degës në Kosovë, nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendit të origjinës, nëse sipas legjislacionit të vendit amë kërkohet një gjë e tillë;
 - 2.3. ta ketë miratimin zyrtar nga organet përgjegjëse të kompanisë ndërmjetësuese amë, për hapjen e degës në Kosovë;
 - 2.4. të prezantojë një letër sigurie e adresuar për BQK-në, nga kompania ndërmjetësuese amë, me anë të së cilës pranon detyrimin ligjor për pagesën e të gjitha obligimeve të degës së saj në Kosovë;
 - 2.5. të jetë e regjistruar në regjistrin e bizneseve në Republikën e Kosovës, në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
 - 2.6. menaxherët e lartë të propozuar të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për veprë penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg si dhe të mos kenë qenë drejtor ose kryeshef ekzekutiv të ndonjë siguresi gjatë gjashtë (6) muajve të fundit nga momenti i aplikimit;
 - 2.7. plani i biznesit për së paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë, i cili duhet të jetë i bazuar në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;
 - 2.8. të ketë të punësuar me kohë të plotë, së paku një (1) agjent respektivisht broker të licencuar nga BQK-ja;
 - 2.9. të paguajë dhe mirëmbajë në çdo kohë kapitalin si fond garantues, në vlerë prej së paku pesë mijë (5,000) euro në rastin e degëve të kompanive të jashtme të agjentëve, ndërsa dhjetë mijë (10,000) euro, në rastin e degëve të kompanive të jashtme të brokerimit. Ky kapital duhet të paguhet në para të gatshme në një nga bankat e licencuara nga BQK-ja dhe të mirëmbahet në çdo kohë;
 - 2.10. të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregullore;
 - 2.11. të ketë objekte të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj sipas përcaktimeve të kësaj rregullore;
 - 2.12. para-kontrata e lidhur me siguresin në emër dhe në llogari të së cilës do të veprojë.
3. Përveç dokumentacionit që vërteton përmbushjen e kriterëve sipas paragrafit 2 të këtij neni, kompania e jashtme ndërmjetësuese, që kërkon të licencohet për të vepruar përmes degës në Kosovë, duhet të paraqes në BQK edhe dokumentet si në vijim:
 - 3.1 Statutin kompanisë së jashtme ndërmjetësuese (kompanisë amë) ose ekuivalentin e tij;

3.2 Raportet financiare të auditura të kompanisë së jashtme ndërmjetësuese, për tri (3) vitet e fundit.

4. Polica e sigurimit të përgjegjesisë profesionale, nuk është e obligueshme të dorëzohet në BQK në momentin e dorëzimit të aplikacionit.
5. Gjatë shqyrtimit të aplikacionit për licencim sipas këtij neni, BQK-ja nëse e vlerëson të nevojshme mund të kërkojë dokumentacion tjetër plotësues.
6. Kërkesa për licencim dhe dokumentacioni sipas këtij neni duhet të jenë në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe të njëjtat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të vërtetuara nga noteri.
7. Për qëllime të shqyrtimit të kërkesave sipas këtij neni, BQK-ja mund të kontaktojë drejtpërsëdrejti edhe me Autoritetet mbikëqyrëse përgjegjëse të kompanisë së jashtme ndërmjetësuese.

Neni 9

Organet udhëheqëse të kompanive ndërmjetësuese në sigurime

1. Organet udhëheqëse të kompanive ndërmjetësuese janë të njëjta sikurse përcaktohen me në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
2. Aksionarët kryesor, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherët e lartë të kompanive ndërmjetësuese në sigurime, kërkohet të aprovohen nga BQK-ja.
3. Drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherët e lartë, duhet të kenë të përfunduar studimet universitare dhe të kenë përvojë së paku një (1) vjeçare në fushën e sigurimeve, veprimtarive tjera financiare apo përvojë menaxheriale në subjektet tjera biznesore të madhësisë së ngjashme me kompaninë e ndërmjetësimit.
4. Dispozitat e këtij neni për degët e kompanive ndërmjetësuese të jashtme, aplikohet vetëm sa i përket menaxherëve të lartë të degës në Kosovë.

Neni 10

Ushtrimi i veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime nga bankat

1. Bankat e licencuara në Republikën e Kosovës, mund të ushtrojnë veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime, vetëm pasi të jenë licencuar nga BQK-ja. Veprimtaria e ndërmjetësimit nga bankat mund të bëhet vetëm nga të punësuarit e tyre të cilët paraprakisht duhet të jenë të licencuar nga BQK-ja si ndërmjetësues në sigurime.
2. Bankat që kërkojnë licencë nga BQK-ja për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime si agjent, duhet të kenë të punësuar së paku një agjent të licencuar.
3. Bankat që kërkojnë licencë nga BQK-ja për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime si broker, duhet të kenë të punësuar së paku një broker të licencuar.
4. Me rastin e shqyrtimit të kërkesës për licencim të bankave si ndërmjetësues në sigurime, duhet të kërkohet edhe një opinion me shkrim nga Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare

në kuadër të BQK-së, i cili duhet të përmbaj vlerësimin për gjendjen e përgjithshme të bankës.

5. Banka që paraqet kërkesë për licencimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime, duhet të paraqes dokumentacionin si në vijim:
 - 5.1.formulari i plotësuar i BQK-së për aplikim;
 - 5.2.certifikata e regjistrimit të biznesit (shtimi i veprimtarisë në regjistrin biznesit)
 - 5.3.vendimin e organit përgjegjës të bankës për angazhimin në veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime;
 - 5.4.planin e biznesit për së paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime, i cili duhet të jetë i bazuar në analiza të sakta dhe supozime të arsyeshme;
 - 5.5.të dhëna për strukturën që do të kryej veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime;
 - 5.6.para-kontrata e lidhur me siguresit në emër dhe në llogari të cilëve do të veprojnë, në rastin kur banka kërkon të licencohet si agjent i sigurimeve;
 - 5.7.dokumentin që vërteton pagesën tarifës për licencim;
 - 5.8.policën e sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregullore.
6. Polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale, nuk është e obligueshme të dorëzohet në BQK në momentin e dorëzimit të aplikacionit;
7. Gjatë shqyrtimit të aplikacionit për licencim sipas këtij neni, BQK-ja nëse e vlerëson të nevojshme mund të kërkojë dokumentacion tjetër plotësues.

Neni 11

Ushtrimi i veprimtarisë së agjentit si ndërmjetësues në sigurime nga agjencionet e udhëtimeve

1. Agjencionet e udhëtimeve, mund të ushtrojnë veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime, vetëm për produktin e sigurimit të shëndetit në udhëtim, vetëm pasi të jenë licencuar nga BQK-ja. Veprimtaria e agjentit në sigurime nga agjencionet e udhëtimit për produktin e shëndetit në udhëtim duhet të bëhet nga agjent të licencuar paraprakisht nga BQK-ja.
2. Agjentet e sigurimeve nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jenë të punësuar të agjencionit të udhëtimit.
3. Agjencioni i udhëtimit që paraqet kërkesë për licencim si agjent për sigurimin e shëndetit në udhëtim, duhet të paraqes dokumentacionin në vijim:
 - 3.1.Formulari i plotësuar i BQK-së për aplikim;
 - 3.2.Certifikata e regjistrimit të biznesit (shtimi i veprimtarisë në regjistrin biznesit);
 - 3.3.Plani i biznesit për së paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë së ndërmjetësimit, i cili duhet të jetë i bazuar në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme.
 - 3.4.Dokumenti që vërteton se agjenti përmes të cilit do të ushtrohet veprimtaria e sigurimit është i licencuar nga BQK-ja si dhe kontrata e punës me agjencionin e udhëtimit;
 - 3.5.Dokument që vërteton disponimin e ambienteve dhe infrastrukturës të nevojshme për shitjen e sigurimit të shëndetit në udhëtim;

- 3.6.Kontrata e punësimit me kohë të plotë për të paktën një (1) agjent të miratuar;
 - 3.7.Para-kontrata e lidhur me siguruesin në emër dhe në llogari të së cilit do të veprojë;
 - 3.8.Dokumentin që vërteton pagesën e tarifës për licencim;
 - 3.9.Policën e sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregullore.
 - 3.10. Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, nuk është e obligueshme të dorëzohet në BQK në momentin e dorëzimit të aplikacionit
4. Gjatë shqyrtimit të aplikacionit për licencim sipas këtij neni, BQK-ja nëse e vlerëson të nevojshme mund të kërkojë dokumentacion tjetër plotësues.

Neni 12

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale

1. Ndërmjetësuesit e licencuar të sigurimeve, obligohen që gjatë gjithë veprimtarisë së tyre të kenë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale, për t'i mbuluar përgjegjësitë profesionale ndaj palëve të treta, që lindin si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tyre. Mbulesa e policës së sigurimit nga përgjegjësia profesionale duhet të jetë në shumë prej dyqind e pesëdhjetë mijë (250,000) euro për një rast të vetëm dhe pesëqind mijë (500,000) euro për të gjitha rastet brenda një (1) viti.
2. Kompanitë ndërmjetësuese, degët e kompanive ndërmjetësuese të jashtme, bankat e licencuara për veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime si dhe agjensionet e udhëtimit të licencuara për veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime, duhet kenë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas paragrafit 1 të këtij neni, në emër të tyre, dhe kjo police i mbulon të gjithë personelin (personat fizik) përmes të cilëve këto kryejnë veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime.

Neni 13

Afati i shqyrtimit të kërkesës dhe licencimi

1. BQK-ja e shqyrton dokumentacionin për licencim në pajtim me kërkesat e Ligjit për Sigurimet dhe këtë Rregullore.
2. BQK-ja brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas ditës së pranimit të aplikacionit, e shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe e njofton aplikuesin me shkrim nëse dokumentacioni është apo nuk është kompletuar.
3. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i kompletuar dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara me Ligjin për Sigurime ose këtë Rregullore, BQK-ja do të njoftojë aplikuesin për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e Ligjit për Sigurime ose kësaj Rregullore, së bashku me kërkesën për informata ose dokumente shtesë që kërkohen. Afati për paraqitjen e informatave ose dokumenteve shtesë është jo me vonë se nëntëdhjetë (90) pas njoftimit sipas këtij paragrafi.

4. Nëse informatat ose dokumentet shtesë të kërkuara sipas paragrafit 3 të këtij neni janë paraqitur brenda afatit, BQK do ta njoftoj palën se aplikacioni është i kompletuar.
5. BQK-ja ndërpret procedurat e shqyrtimit të aplikacionit për licencim në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga aplikuesi brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës së njoftimit sipas paragrafit 3 të këtij neni. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të aplikacionit për licencim, BQK-ja e njofton me shkrim aplikuesin.
6. BQK-ja nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon licencimin e kompanisë ndërmjetësuese në sigurime, degëve të kompanive ndërmjetësuese të jashtme si dhe bankave dhe agjensioneve të udhëtimit, që kanë aplikuar tu licencuar për veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime, brenda tre (3) muajve nga data e njoftimit të aplikantit se aplikacioni për licencim është i kompletuar. Për vendimin e marrë BQK-ja menjëherë e informon aplikuesin.
7. Gjatë periudhës së shqyrtimit të aplikacionit BQK-ja mund të kërkojë informata shtesë apo ndryshime/përmirësime të caktuara kur vlerësohen të arsyeshme. Kërkesa për informata shtesë sqaruese në këtë fazë nuk do të ndikojë në zgjatjen e periudhës prej nëntëdhjetë (90) ditësh për të vendosur rreth kërkesës për licencim, sipas paragrafit 6 të këtij neni.
8. Në rastet e kërkesave për licencim të ndërmjetësuesve si persona fizik, afatet nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni do të jenë tridhjetë (30) ditë, ndërsa afati nga paragrafi 6 i këtij neni është katërdhjetë e pesë (45) ditë.
9. Licenca lëshohet për kohë të pacaktuar, është e lidhur me subjektin e licencuar dhe nuk mund të transferohet te subjekte tjera.
10. Licenca duhet të specifikojë klasat e sigurimit, për të cilat i licencuari autorizohet të ndërmjetësojë.
11. BQK-ja do ta refuzoj kërkesën për licencim, nëse nuk janë përmbushur kërkesat e Ligjit për Sigurime dhe të kësaj Rregullore. Në rast të refuzimit të kërkesës për licencë, BQK-ja do t'i paraqes arsyet mbi bazën e të cilave është bërë refuzimi.
12. Licenca e ndërmjetësuesit në sigurime mund të revokohet, përfundohet apo pezullohet sipas përcaktimeve të nenit 118 paragrafët 5, 6 dhe 7 dhe nenit 124 të Ligjit për Sigurimet.

Neni 14

Provimi dhe edukimi i vazhdueshëm profesional

1. Provimi dhe edukimi i vazhdueshëm profesional do të organizohet nga Shoqata e Sigurimeve apo subjekte tjera, të miratuara nga BQK-ja.
2. Përmbajtjet e testeve të provimit profesional për ndërmjetësues të sigurimeve duhet të miratohet nga BQK-ja. Këto teste në minimum duhet të përmbajnë pyetje bazike nga fusha e sigurimeve, drejtësia, etika profesionale, ekonomia, dhe konfidencialiteti.

3. Komisioni për vlerësimin e testeve të provimit profesional për ndërmjetësues, përbëhet nga tre anëtar, dy anëtar caktohen nga shoqata e sigurimeve ose subjekti tjetër i miratuar nga BQK-ja dhe një anëtar do të caktohet nga BQK-ja.
4. Shoqata e Sigurimeve apo subjektet tjera për organizimin e trajnimeve profesionale duhet ta njoftojnë BQK-në për modulet e trajnimeve për ndërmjetësues të sigurimeve.
5. Agjentët në sigurime obligohen që të kenë edukim të vazhdueshëm profesional së paku dhjetë (10) orë brenda vitit, ndërsa brokerët së paku njëzet (20) orë brenda vitit.

Neni 15

Tarifat

1. Secili personi fizik apo juridik që aplikon për t'u licencuar si ndërmjetësues në sigurime duhet të paguajë tarifën e licencimit në shumat e aprovuara nga BQK-ja.
2. Tarifa sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të paguhet nga aplikanti në momentin e paraqitjes së kërkesës për licencim. Kjo tarifë është e pakthyeshme.

Neni 16

Hapja, zhvendosja dhe mbyllja e zyrave

1. Kompanitë ndërmjetësuese në sigurime, para se të themelojnë një subjekt të varur ose hapin një degë në ndonjë juridiksion tjetër duhet të marrin miratim paraprak nga BQK-ja.
2. Nëse një kompani ndërmjetësuese ose degë e kompanisë ndërmjetësuese të jashtme vendos ta zgjerojë veprimtarinë e vet brenda Kosovës, duke hapur degë të reja ose të zhvendos zyrat ekzistuese, përfshirë selinë qendrore të saj, duhet që paraprakisht të marrë miratim nga BQK-ja.
3. Agjentët dhe brokerat që janë licencuar të zhvillojnë veprimtari si persona fizik, duhet ta marrin miratimin me shkrim të BQK-së, para se të zhvendosin zyrat ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.
4. BQK-ja mund të jap miratimin edhe para kryerjes së ekzaminimit në lidhje me plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë Rregullore. Megjithatë, pas kryerjes së ekzaminimit, BQK-ja ka të drejtë të pezullojë ushtrimin e veprimtarisë së zyrave, nëse ajo konstaton se kushtet teknike për ushtrimin e veprimtarisë, nuk janë përmbushur. Në raste të tilla, përveç pezullimit për ushtrimin e veprimtarisë së zyrave, BQK-ja do të ndërmarr edhe masa të tjera ndëshkuese ndaj ndërmjetësuesit, të parapara sipas legjislacionit në fuqi.
5. Në rastet e zhvendosjes zyrës, ndërmjetësuesi, duhet të njoftojë paraprakisht klientët e asaj për zhvendosje të zyrës si dhe lokacionin e ri, duke shpallë njoftimin në mënyrë të dukshme në lokalet e zyrës, së paku 30 ditë para datës së propozuar të zhvendosjes.
6. BQK-ja vendos për miratimin apo refuzimin e kërkesës për hapje ose zhvendosje të zyrës brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar.

7. Për mbylljen e degëve dhe zyrave, ndërmjetësuesit duhet ta njoftojnë BQK-në së paku 30 ditë para datës së propozuar të mbylljes.

Neni 17

Mjedisi për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime

1. Mjedisi, ku do të ushtrohet veprimtaria e ndërmjetësuesit, duhet të plotësojë të paktën këto kërkesa:
 - 1.1 Të ketë hapësirë jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) metra katror si dhe kushte të përshtatshme për mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe pajisjeve të punës.
 - 1.2 Të ketë pajisjet e nevojshme teknike për ushtrimin e veprimtarisë dhe tabelë ku paraqiten të dhënat mbi ndërmjetësuesin si dhe primet e produkteve të sigurimit të cilat i ndërmjetësojnë.
2. BQK-ja mund të nxjerr udhëzim për të përcaktuar kritere tjera shtesë për mjediset e ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësuesit.

Neni 18

Dividenda për kompanitë ndërmjetësuese në sigurime

1. Kompanitë ndërmjetësuese nuk mund të shpërndajnë kurrfarë dividende për aksionarët/pronarët, pa miratimin paraprak me shkrim nga BQK-ja.
2. BQK-ja mund ta refuzojë kërkesën për shpërndarje të dividendës, nëse sipas vlerësimit të saj, pagesa e dividendës do ta vështirësonte gjendjen financiare të kompanisë ndërmjetësuese.

Neni 19

Ndryshimet tjera që kërkojnë miratim paraprak nga BQK-ja

1. Ndryshimet në vijim nga kompanitë ndërmjetësuese të sigurimeve, kërkojnë miratimin paraprak nga BQK-ja:
 - 1.1. Ndryshimet në aksionar kryesor që janë të barabarta ose tejkalojnë dhjetë përqind (10%), njëzet përqind (20%), tridhjetë përqind (30%) dhe pesëdhjetë përqind (50%) të drejtave të votës ose pjesëmarrjes në kapitalin e kompanisë ndërmjetësuese të sigurimeve;
 - 1.2. Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit;
 - 1.3. Ndryshimi i emrit;
 - 1.4. Ndryshimet e drejtoreve (kur është e aplikueshme) dhe menaxhereve të lartë;
 - 1.5. Auditori i jashtëm;
 - 1.6. Bashkimet dhe përvetësimet.

Neni 20
Administrimi i përkohshëm

1. BQK-ja me qëllim të rikthimit të kompanisë ndërmjetësuese të sigurimeve në gjendje financiare të qëndrueshme, mund të marr vendim për vënien nën administrim të përkohshëm për kompaninë, në rastet e mëposhtme:
 - 1.1. Nëse kompania ndërmjetësuese në sigurime nuk zbaton urdhëresat e BQK-së brenda afatit kohor të përcaktuar;
 - 1.2. Pavarësisht masave të përcaktuara me urdhëresë të BQK-së, kompania ndërmjetësuese nuk arrin të ketë gjendje financiare të qëndrueshme;
2. BQK-ja me vendimin për caktimin e administrimit të përkohshëm, cakton edhe periudhën kohore të administrimit të përkohshëm.
3. Dispozitat e kapitullit XVII të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet që rregullojnë administrimin e përkohshëm të siguresve, aplikohen përshtatshëmrisht edhe për administrimin e përkohshëm të kompanive ndërmjetësuese në sigurime.

Neni 21
Likuidimi vullnetar dhe i detyruar

1. Nëse pronarët ose aksionaret e kompanisë ndërmjetësuese të sigurimeve vendosin që vullnetarisht ta likuidojnë kompaninë ndërmjetësuese, në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare apo çfarëdo ligji tjetër, në fuqi në Republikën e Kosovës, duhet ta paraqesin në BQK kërkesën për miratimin e likuidimit vullnetar, të shoqëruar me të dhëna që i kërkon BQK-ja.
2. BQK-ja pasi ti vlerëson të dhënat e pranuar, nëse vlerëson se interesat e kreditorëve mbrohen në mënyrë të mjaftueshme, mund të miratojë likuidimin vullnetar sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo çfarëdo ligji tjetër, në fuqi në Republikën e Kosovës.
3. Nëse BQK-ja vlerëson se interesat e kreditorëve nuk mbrohen në mënyrë të mjaftueshme, refuzon kërkesën për likuidim vullnetar dhe mund të vendos zbatimin e likuidimit nga ana e likuidatorit të emëruar nga BQK-ja.
4. Para se të vendos cilëndo nga mënyrat e likuidimit sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, BQK-ja revokon licencën e kompanisë ndërmjetësuese të sigurimeve.
5. Dispozitat e kapitullit XVIII të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet, që rregullojnë likuidimin e siguresve, aplikohen përshtatshëmrisht edhe për likuidimin e kompanive ndërmjetësuese të sigurimeve.

Neni 22
Masat administrative, dënimet me gjobë dhe pezullimi apo largimi i personave

Çdo shkelje e kësaj rregullore do të jetë subjekt i masave nga Nenet 124, 125 dhe 126 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet.

Neni 23
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje do të shfuqizohet Rregullorja për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime e datës 29 gusht 2014, si dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me të.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci